



**AKT THEMELEMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR**  
**“Tetra PRO” SH.P.K.**

**Tirane 13.09.2022**

**NENI 1**

Në Tiranë, sot me datën 13.09.2022, në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 ‘Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare’ I ndryshuar dhe Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 ‘Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit’, themelohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin **“Tetra PRO” SH.P.K.**

**NENI 2**

Ortakët themelues të shoqërisë janë :

**-Sokol Qeraxhiu** me nr. karte indentiteti H10516142M i biri i Mehmet dhe File, i datëlindjes 16.05.1971, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë , Rezidenca Longhill, Nr.85, Mullet, Tiranë.

**NENI 3**

***Emërtimi***

Emërtimi i plotë i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar është **“Tetra PRO”**

**NENI 4**

***Selia***

Shoqëria e ka seline e saj në Tiranë, Kompleksi KIKA 2, Rruga “Tish Daia”, kati i dytë, godina Nr.7, njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë.

Përveç ushtrimit të aktivitetit në nivel qendror, shoqëria ka të drejtë të hap dege dhe zyra perfaqesimi brenda vendit ose jashtë vendit.

Selia e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme.

**NENI 5**

***Kohëzgjatja***

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, dhe do të fillojë nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vendos Asambleja e Përgjithëshme.



**NENI 6**  
**Objekti i Veprimtarisë**

Objekti i Veprimtarisë është:

- Krijim, zbatim, integrim te sistemeve te informacionit dhe te programeve kompjuterike ne paisje locale ose ne server ne cloud. Import export tregti te pajisjeve, programeve apo sherbimeve ne fushen e teknologjise se informacionit. Konsulenca dhe mirembajtja e tyre. Operim, zbatim, dhenie me qera e sistemeve dhe e pajisjeve te ndryshme informatike qe sherbejne per administrimin e operacioneve te ndermarrjeve, shitje ne/ internet, sisteme te fiskalizimit dhe te ngjashem me perdorim si brenda ndermarrjeve ashtu edhe ne marredheniet me klientelen. Dhenie e sherbimeve ne fushen e teknologjise se informacionit ne formen e platformave te qerases te programeve (software as a service).

**NENI 7**  
**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerisë është 100 000 Lekë. Ky kapital është i përberë nga nje kuote me vlerë prej 100 000 lekë të nënshkruar nga ortaku themelues i shoqerisë **Sokol Qeraxhiu**. Ky eshte kapitali efektiv qe nga regjistrimi i shoqerise.

**NENI 8**

Administrator i shoqerisë do të jete **Z. Sokol Qeraxhiu**.

**NENI 9**

Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te Statutit dhe ketij Akti Themelimi te kesaj shoqerije.

**NENI 10**  
**Dispozita e fundit**

Ky akt themelimi është perpiluar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

**ORTAK ËT THEMELUES**

**Sokol Qeraxhiu**